

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-148/2015

Prishtinë,

25 tetor 2017

Në çështjen juridike të:

S. P. M.

Në emër të bashkëshortit

D. M.

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronave, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami Kryetar i Kolegjit, Gjyqtarët Krassimir Mazgalov dhe Shukri Sylejmani, Anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KKPK/D/C/240/2014 lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave (më tej AKP) me numrin KPA34342 i datës 30 Prill 2014, pas seancës gjyqësore kryesore, të mbajtur më 25 tetor 2017, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e S. P. M. e paraqitur kundër vendimit të KPCC/D/C/240/2014 i datës 30 Prill 2014 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA34342, refuzohet si e pabazuar.
2. Konfirmohet vendimi i KPCC/D/C/240/2014 i datës 30 Prill 2014 sa i përket lëndës së regjistruara në AKP me numrin KPA34342.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 9 Maj 2007, S. P. M. (më tutje “pala Ankuese”), ka parashtruar një kërkesë në AKP e regjistruar në nr. KPA34342, duke pretenduar të drejtën pronësore në emër të bashkëshortit D. M. dhe kërkon kthimin e posedimit të lokaleve afariste të cilat gjenden në rrugën “Kosmetskih Brigada” pn. në Prishtinë, objektet 8,9 dhe 16 me sipërfaqe prej 89.62 metra katrorë. Deklaron se prona e ish ndërmarrjës shoqërore Ndërmarrjës publike për veshmbathje ushtarake dhe civile “22 Decembar” Nish/Niš është blerë me privatizim në vitin 2003 nga autoriteti i privatizimit i Serbisë në Beograd dhe dhe se e ka humbur posdimin në Qershor të Vitit 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën e saj ajo ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:
 - Kontratë e lidhur në mes të Kombinatit Xehtar-Metalurgjik-Energjetik “Kosovo” nga Prishtina dhe Ndërmarrjës publike për veshmbathje ushtarake dhe civile “22 Decembar” Nish/Niš e lidhur me 5 Tetor 1968 për ndërtimin e objekteve banesore afariste në Prishtinë në rrugën “Kosmeskih Brigada”
 - Kontratë mbi shitblerjen e kapitalit shoqërorë me aukcion e lidhur mes Agjencisë për Privatizim të Serbisë në Beograd dhe bashkëshortit të paraqitëses së kërkesës e vërtetuar në Gjykatën e Parë Themelore në Beograd me numër I/ov.nr.4354/03 datë 11 Tetor 2003.
 - Certifikatë e martesës e lëshuar nga Komuna e Nishit në Serbi me 27 Mars 2008 me të cilën dëshmohet se paraqitësja e ankesës është e martuar me Dragoslav Markić
3. Ekipi i notifikimit i AKP-së sipas raportit të verifikimit të datës 3 shtator 2009, ka konstatuar se prona e kërkuar nuk mund të identifikohet mbi bazën e të dhenave nga parashtruesi i kërkesës dhe për këtë arsye ka kontaktuar paraqitësin e kërkesës për të dhena plotësuese lidhur me adresën e pronës së kërëuar. Me 11 mars 2009 paraqitësja e ankesës u kishte deklaruar zyrtarëve të AKP-së se ajo është drejtor i kompanisë por nuk e di ku ndodhet prona.
4. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të datës 21 Tetor 2011, Kontrata e privatizimit të pronës në Gjykatën e parë Themelore të Beogradit ishte gjetur dhe verifikuar pozitivisht.

5. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KPCC/240/2014 që i referohet lëndës së regjistruar në AKP me numrin KPA34342 i datës 30 Prill 2014 ka vendosur që kërkesa të refuzohet, me arsyetim se paraqitësi i kërkesës fillimisht kishte deklaruar se e ka humbur posdimin si pasojë e konfliktit të armatosur por në bazë të dokumentave të parashtruara dhe kërkimeve “ex officio” të Sekretariatit ka rezultuar se ai nuk ka mundur të paraqes asnjë dëshmi valide e as Sekretariati nuk ka gjetur dëshmi se para konfliktit të armatosur ka pas ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar dhe që të njetën e ka humbur si pasojë e konfliktit.
6. S. M. në cilësinë e palës ankuese, në emër të bashkëshortit, vendimin e Komisionit e ka pranuar më 30 Tetor 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 21 Nëntor 2014.

Pranueshmëria e ankesës

7. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore sipas nenit 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 mbi procedurën kontestimore (Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.38/2008) (në tekstin e mëtejme LPK), Gjykata lidhur me shqyrtimin e aktgjykimit sipas detyrës zyrtare dhe për shkaqet e cekura dhe jo të cekura në ankesë gjeti se ankesa është e pranueshme dhe e afatëshme sipas nenit 186 par. 1 lidhur me nenin 196 të LPK-së për arsye se pala ankuese vendimin e Komisionit e ka pranuar më 30 Tetor 2014, ndërkaq ankesë ka paraqitur më datë 21 Nëntor 2014. Nga kjo mund të konstatohet se ankesën e ka paraqitur në afatit prej 30 ditësh të parashikuar me dispozitën e nenit 12 par. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-79. Me këtë dispozitë ligjore parashikohet se “*ankesa kundër vendimit të KPCC mund të ankimohet brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e pranimit*”.

Pretendimet Ankimore:

8. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është marr në shkelje për shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjës faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Më tej e kundërshton arsyetimin e KKPK-së se prona nuk është humbur si rezultat i konfliktit duke pohuar se dokumentat e parashtruara deshmojnë pronësinë mbi pronën e kërkuar e ka fituar ndërmarrja “22 Decembar “ me aktgjykimin e Gjykatës ekonomike të Prishtinës numër III П. Br. 2121/94 i datës 7 Tetor 1994 me të cilin si bashkë ndertues e ka fituar pronësinë në objektet afariste pronë e kërkuar. Pala ankuese i ka bashkangjitur edhe kontratat për dhenje me qira të këtyre lokaleve. Me privatizimin e vitit 2003 paraqitesja e ankesës pretendon se është pronë e bashkëshortit të saj si privatizues. Ajo pretendon se lokalet kanë qenë në shfrytëzim me qira deri në shpërthimin e konfliktit nga subjekt të ndryshem dhe tani ato janë në posedim pa te drejte ligjore prandaj KKPK-ja do të duhej ta njihnte pronësinë dhe të kthente posedimin mbi pronën e kërkuar.

Meritat e Ankesës:

Gjykata gjeti se Ankesa e parashtruar ndaj vendimit të Komisionit është e pa bazuar për faktin se paraqitësi i kërkesës dhe pala ankuese nuk kanë dëshmuar se kanë pas të drejtë pronësore të regjistruar në regjistra publik dhe se të njetën e kanë humbur si pasojë e konfliktit të armatosur dhe rrethave që lidhen me konfliktin. Dokumentat e parashtruara të palës ankuese dëshmojnë se deri në vitin 2003 prona e kërkuar ka qenë pronë shoqërore e ndërmarrjes “22 Decembar” nga Nishi dhe tek në vitin 2003 nga një autoritet i privatizimit në Serbi i cili nuk kishte shtrije kompetence në Kosovë pasi që pronat shoqërore në Kosovë administroheshin nga Agjencia Kosovare e Mirobesimit (tani e privatizimit).

Juridiksioni:

9. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, KKKP-ja ka kompetencë për t’i zgjidhur kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999: (a) kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe (b) kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme **private**, ku pretenduesi i pronës nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat të tilla pronësore.
10. Për këtë lëndë, është e nevojshme të përcaktohet nëse pala përgjegjëse ka pas prova se ka qenë pronar i pronës së kërkuar, se e ka pas në shfrytëzim dhe se e ka humbur si pasojë e konfliktit. Të dhënat kadastrale tregojnë se gjatë kohës së konfliktit prona ka qenë e regjistruar si shoqërore. Neni 20 i Ligjit mbi Mardhënjet pronësore juridike (Gaz.Zyrtare e RSFJ Nr 6/80, 36/90 parasheh se “*E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj*”- që nënkupton formën me shkrim vërtetimin e autoritetit dhe regjistrimin e pronës në regjistra publik. Edhe Ligji aktual nr. 03/1-154 Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në nenin 36 parasheh se “*1. Për bartjen e pronësisë në paluajtshmeri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmeri.*”
11. Pala përgjegjëse në ankesë nuk ka dëshmuar se para konfliktit e kishte ekzekutuar të drejtë pronësore dhe posedim mbi pronën e kërkuar të cilën e ka humbur si pasojë e konfliktit dhe ky konstatim i KKKP-së nuk u kundërshtua me asnjë provë të re sipas ankesës. Këtë e dëshmojnë edhe shkresat e bashkangjitura ankesës si lista poseduese Nr.2471 e lëshuar nga autoritetin kadastral i Prishtinës i dislokuar në Serbi që dëshmon se njeri nga lokalet-pronë e kërkuar evidentohet si pronë shoqërore e Kombinatit “Kosovo”
12. Gjykata Supreme e Kosovës –Kolegji i Ankesave gjeti se ankesa është e pa bazuar dhe pala ankuese nuk arritur të dëshmoi se ka pas të drejtë pronësore para apo gjatë konfliktit dhe se e njeta është humbur si pasojë e konfliktit apo rrethanave që lidhen me të. Gjykata nuk i shqyrtoi meritat e kontratës së privatizimit në vitin 2003 në Serbi pasi që kjo lëmi është e

regulluar fillimisht me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/12, për themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, me ndryshimet dhe plotësimet e saj, dhe tani me Ligji Nr. 03/L-067 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit si autoritet i vetëm i privatizimit në Kosovë. Nëse merret parasysh edhe përkufizimi kohor i mandatit të KPPK-së që është ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999, Gjykata Supreme konstaton gjatë kësaj periudhe pala ankuese e as bashkëshorti i saj nuk kanë pasë të drejtë pronësie dhe se rrjedhimisht vendimi i KPPK-së është i drejtë dhe i nxjerrë në zbatim të dispozitave të ligjit procedural dhe material.

13. Ky aktgjykim nuk paragjykon asnjë të drejtë pronësore të konfirmuar për shfrytëzuesin aktual dhe nuk është pengesë për konfirmimin e të drejtave pronësore në procedurë të rregullte
14. Duke pas parasysh të mësipërmen, Gjykata Supreme vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

15. Sipas 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit,

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Shukri Sylejmani, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, Ushtrues Detyre i Referentit të EULEX-it